

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

SPITALI MEMORIAL FIER

Nr. 611/32 ProtNr. 1380 ProtVlorë më 22 . 09 .2022Fier më 22 . 09 .2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

DHE

SPITALIT MEMORIAL FIER

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i arsimit të lartë publik, përfaqësuar nga Prof. Dr. Roland Zisi, Rektori i Universitetit.

dhe

Spitali Memorial Fier, përfaqësuar nga znj. Rudina Degjoni, Drejtoreshë e Spitalit.

nisur nga interesi për zhvillimin e aktiviteteve me karakter arsimor, nisur nga shërbimet që ofron ky spital dhe me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin tonë palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja")

*Neni 1***Baza Ligjore**

Kjo, Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 28, pika 5, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 17.3.2021 "Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal "Memorial" Në Fier, si projekt pilot" si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 26.1.2022 "Për miratimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal "Memorial" në Fier, gjatë fazës kalimtare".

*Neni 2***Qëllimi dhe mënyra e bashkëpunimit**

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Universitetit dhe Spitalit duke përfshirë:

- ✓ Vënie në dispozicion të personelit mjekësor dhe infermieror të spitalit për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të Fakultetit të Shëndetit në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë (më tej referuar si FSH).
- ✓ Angazhimin e studentëve të FSH në procedurat infermiore të institucionit (nga marrja e anamnezës deri tek ndjekja e terapisë).
- ✓ Bashkëpunimin e pedagogëve të FSH, personelit mjekësor dhe infermieror të Spitalit, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve klinike dhe kërkimit shkencor mjekësor.
- ✓ Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).
- ✓ Sigurimin e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të institucionit për realizimin e seancave mësimore të praktikave profesionale.
- ✓ Realizimin e praktikave klinike (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushës së shëndetit, të ofruara nga FSH.

Neni 3

Sfera e bashkëpunimit

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali"
- Shërbimi i Patologjisë
- Shërbimi i Kirurgjisë
- Shërbimi Infektiv

Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në tre cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor)
- Cikli i tretë i studimeve të Doktoratës

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara.
- Praktikant mësimore
- Praktikant profesionale
- Projektet kërkimore klinike
- Detyrat e kursit mbi bazën e ekzaminimit të rasteve klinike.

Neni 4

Detyrimet e palëve

Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Personeli i Fakultetit të Shëndetit, studentët e programeve mësimore të FSH si dhe personeli mjekësor i Spitalit Memorial janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakort nga titullarët e të dy institucioneve.

Amendamente të mundshme ose shtesa të tjera të kësaj Marrëveshjeje mund të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6

Mirëbesimi

Universiteti dhe Spitali Memorial do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhenat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

- Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.
- Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
- Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

- Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
- Kjo marrëveshje është hartuar në dy (3) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe Fakultetin e Shëndetit, një kopje do të depozitohet në Spitalin Memorial Fier

PËR

UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

Prof. Dr. ROLAND ZISI



PËR

SPITALIN MEMORIAL FIER

DREJTOR

Znj. RUDINA DEÇJONI

